



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

## KËSHILLI I EMËRIMEVE NË DREJTËSI

### PROCESVERBAL <sup>1</sup>

*(I përmbledhur)*

Tiranë, më 01.03.2019, ora 13.00

**Drejton mbledhjen -  
Ardian Dvorani – Kryetar i Këshillit**

#### **Rendi i Ditës :**

*1.Diskutimi dhe miratimi i Projektvendimit për procedurat e verifikimit të kandidatëve për vendet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe për Inspektor i Lartë i Drejtësisë.*

*2.Shpallja për hapjen e Procedurës së Aplikimit në Pozicionin Vakant për Inspektor i Lartë i Drejtësisë.*

#### **Marrin pjesë :**

- |                                |                        |
|--------------------------------|------------------------|
| 1. Ardian Dvorani              | (kryetar)              |
| 2. Vitore Tusha                | (zëvendës kryetare)    |
| 3. Arta Marku                  | (anëtare)              |
| 4. Fatri Islamaj               | (anëtar)               |
| 5. Margarita Buhali            | (anëtare)              |
| 6. Fatjona Memçaj <sup>2</sup> | (anëtare)              |
| 7. Eriol Roshi                 | (anëtar)               |
| 8. Medi Bici                   | (anëtar zëvendësues)   |
| 9. Gurali Brahimllari          | (anëtar zëvendësues)   |
| 10. Klodiana Veizi (Mema)      | (anëtare zëvendësuese) |

<sup>1</sup>Për shkak të parashikimit shprehimisht në ligjin nr.115/2016 (neni 226 pika 1 shkronja "d", neni232 pika 2, neni 242 shkronja "c") dhe Rregullores së Brendshme të Funksionimit të KED-së (neni 17), referuar pengesës ligjore për të bërë publike diskutimet e vetë anëtarëve të KED për çështjen e rendit të ditës, natyra përmbledhëse e procesverbalit, imponon që edhe diskutimet e Avokatit të Popullit dhe subjekteve të fituara të pasqyrohen në mënyrë të përmbledhur. KED, disponon materialin e plotë audio dhe te zbardhur me shkrim të çdo mbledhje, sipas ligjit.

<sup>2</sup> *Anëtarja Fatjona Memçaj*, pas heqjes dorë nga pjesëmarrja në diskutimin dhe miratimin e akteve nënligjore, për shkak të papajtueshmërisë- marrëdhënie krushqie e afërt me kandidaten Ardita Alsula (miratuar me vendimin nr.1 datë 14.02.2019 të Kryetarit të Këshillit) merr pjesë vetëm në diskutimin e çështjes për shpalljen e hapjes së Procedurës së Aplikimit në Pozicionin Vakant për Inspektor i Lartë i Drejtësisë.

**Merr pjesë, si vëzhguese e përhershme :**

1. Erinda Ballanca, Avokate e Popullit

**Marrin pjesë, si të ftuar, përfaqësues nga subjektet e treguar në nenin 233/2 të ligjit nr. 115/2016 :**

1. Bledar Dervishaj, përfaqësues i Presidentit të Republikës.

2. Mimoza Arbri, përfaqësuese e Kryetarit të Kuvendit.

**Marrin pjesë, si të ftuar, përfaqësues nga institucionet ndërkombëtare, mbështetëse të procesit të hartimit të akteve nënligjore të KED :**

1. Agnes Bernhard, drejtuese e EURALIUS

2. Julinda Beqiraj, eksperte e EURALIUS

3. Maniela Sota, Koço Bendo, përkthyes për EURALIUS

#### **HAPET MBLEDHJA**

*Kryetari i Këshillit Ardian Dvorani*, deklaron të hapur mbledhjen.

Verifikohet prania dhe pjesëmarrja e anëtarëve të Këshillit.

*Ardian Dvorani* lexon çështjet e rendit të ditës të njoftuar paraprakisht:

*Diskutimi dhe miratimi i Projektvendimit për procedurat e verifikimit të kandidatëve për vendet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe për Inspektor i Lartë i Drejtësisë.*

Shtrohet për diskutim miratimi i rendit të ditës së paraqitur për këtë mbledhje të Këshillit.

*Ardian Dvorani* propozon të shtohet një çështje tjetër në rendin e ditës për diskutimin e mundësisë së shpalljes nga KED për hapjen e Procedurës së Aplikimit në Pozicionin Vakant për Inspektor i Lartë i Drejtësisë.

*Anëtarët e Këshillit miratojnë rendin e ditës së programuar si edhe shtesën për çështjen e shpalljes së procedurës së aplikimit për vendin vakant të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.*

*Ardian Dvorani* sjell në vëmendje të anëtarëve të Këshillit dhe pjesëmarrësve në mbledhje se, për çështjen e shtuar të rendin të ditës, meqenëse *anëtarja Fatjona Memçaj* nuk ka pengesë ligjore dhe në kushtet kur ndodhet në ambientet ku zhvillohet mbledhja e Këshillit, duhet të njoftohet për të marrë pjesë për diskutimin dhe votimin përkatës lidhur me vendin vakant të ILD. Për rrjedhojë sugjerohet të vijojë mbledhja me çështjen shtesë, mbi

diskutimin e *shpalljes së procedurës së aplikimit për vendin vakant të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë*.

Pas dakordësisë së *anëtarëve të Këshillit*, paraqitet dhe merr pjesë, vetëm në diskutimin dhe vendimmarrjen e kësaj pike shtesë të rendit të ditës, *anëtarja Fatjona Memçaj*.

*Këshilli* fillon diskutimin lidhur me *shpalljen e procedurës së aplikimit për vendin vakant të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë*.

*Ardian Dvorani* paraqet dhe relatohet hollësisht përpara Këshillit parashikimet që përmban Kushtetuta dhe legjislacioni lidhur me Inspektorin e Lartë të Drejtësisë, përfshirë edhe dispozitat kalimtare për këtë qëllim, ecurinë e kandidimeve për këtë vend vakant dhe gjendjen aktuale kur janë në garë vetëm 3 kandidatë, ndërkohë që Kushtetuta përcakton se Kuvendi e përzgjedh Inspektorin nga një listë prej 5 kandidatësh të renditur nga Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, si edhe afatet dhe rrugët e zgjidhjeve të mundshme lidhur me vijimin e procedurave për plotësimin e vendit vakant të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

*Anëtarët e Këshillit dhe pjesëmarrësit e tjerë* diskutojnë lidhur me parashikimet ligjore, gjendjen e numrin e kandidaturave ekzistuese dhe rrugët e zgjidhjes për procedurat e plotësimit të vendit vakant të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

*Erinda Ballanca*, pas diskutimeve të anëtarëve, kërkon fjalën dhe parashtron se kjo është një çështje e cila po përsëritet për çfarëdo lloj pozicioni, pra nuk është hera e parë që po diskutohet çështja e mospasjes së numrave të parashikuara ose mundësive për të bërë përzgjedhje për organe të ndryshme të reformës në drejtësi. Edhe institucioni i Avokatit të Popullit ka hasur të njëjtin problem kur sipas ligjit u angazhua në procedurat e zgjedhjeve të anëtarëve të vetingut dhe me pas atë të anëtarëve nga shoqëria civile dhe nga Dhoma e Avokatisë për KLP dhe KLGJ. Kjo tregon se duhet të ishte trajtuar dhe menduar më mirë çështja në momentin që është hartuar ligji. Duhet të ndajmë se cila është çështja më e rëndësishme këtu. Pra a do të kemi garë apo duhet të mbetemi pas një numri të vogël kandidatësh apo pas një date apo të themi një afat i cili për hir të së vërtetës ka rezultuar i pamundur për tu realizuar. Çështja më e rëndësishme është të sigurojmë garën, të sigurojmë kualitet, prandaj duhet të prevalojë ajo që ne duhet të mundohemi ti japim mundësinë reale Kuvendit për të pasur më shumë se një apo dy kandidatura.

Institucioni që përfaqësoj është anatemuar kaq gjatë për faktin se nuk po bënte procesin e përzgjedhjeve të kandidaturave për KLP, megjithëse po bënim gjithçka por nuk kishte kandidatë dhe nuk kishte kualitete. Në keto kushte duhet të behet rishpallja e pozicionit vakant. Për rastet e komisioneve të vetingut Avokati i Popullit nuk e ka ribërë shpalljen për

vakancën, megjithëse nuk kishte personat që të plotësonin kriteret sepse konsideronte që kishte një afat kushtetues të përcaktuar, ndaj edhe iu dha afat dhe kohë personave të sillnin dokument shtesë për të përmirësuar pozicionin e tyre të kandidimit. Vlerësoj nivelin e diskutimit në këtë organ sepse realisht janë kualitative dhe jam besimplotë që do të gjendet rruga e duhur për të mirën e çështjes.

E diskutueshme është që të mos nisemi nga shpejtësia dhe të ruajmë parimet. Në këtë pikë jemi me mendimin e shfaqur nga një anëtar që edhe kandidatët e mëparshëm mund të paraqesin dokumente shtesë bashkë me rikonfirmimin e interesit për kandidimin. Nga ana tjetër duhet të kemi të qarta kriteret e vlerësimit sepse mund të ketë dhe kandidatë që në pamundësi ose padijeni se kush janë procedurat mund të paraqesin ose mos të paraqesim kandidaturën. Kështu që do të ishte mirë që këtë shpallje të binim dakord ta bëjmë pasi të kishim mbaruar me rregullat e verifikimit dhe të vlerësimit.

**Bledar Dervishaj**, kërkon fjalën dhe parashtron se e shqyrtuam me vëmendje edhe informacionin e sjellë në këtë mbledhje lidhur me këtë çështje. Ndjehe mi mirë që u shtrua për diskutim tani kjo çështje. Është momenti i duhur, të paktën kështu e vlerësojmë, dhe më vjen akoma më mirë që shumica e anëtarëve të Këshillit e mbështet aktin. Ky Këshill është drejtpërdrejt organ kushtetues dhe qëllimi që do të realizojë është interes publik i madh, përzgjedhjen e kandidatëve për Inspektorin e Lartë të Drejtësisë dhe për të gjithë anëtarët e Gjykatës Kushtetuese, dhe është qëllim kushtetues. Këshilli sot e di që po të ecë me këto kandidatura do të kemi një rezultat jo të mirëpritur nga Kuvendi, ndoshta të refuzueshëm. Ata presin 5 kandidatë dhe jo dy gjithmonë ndoshta nëse ndodh kështu. Interpretimi që bën Këshilli për ta rihapur garën është qëllim pozitiv, është shumë i mirë. Kështu që vlerësojmë se rihapja e garës duhet të mbështetet si ide. Koha pastaj është një detaj shumë i hollë. Ndoshta, mund të veprohet pak më vonë, sa të konsolidohen edhe draftet që mos të duket sikur ndikohet nga hapja e garës drafti dhe përmbajtja e draftit. Pra të kalojë drafti e pastaj vijohet me hapjen e garës.

**Mimoza Arbri**, kërkon fjalën dhe parashtron se si përfaqësuese e Kryetarit të Kuvendit, duke u njohur me relacionin e shpërndarë në lidhje me rishpalljen e pozicionit vakant të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, shprehemi dakord për rishpalljen e tij. Të krijohet mundësia për të ardhur një numër sa më i madh kandidatësh, duke mundësuar garën dhe përzgjedhjen e kandidaturave më të mira të mundshme nga KED. Kështu që jemi dakord me propozimin. Për sa i përket procedurave ato janë kompetencë e juaja për të vendosur.

**Agnes Bernhard** (përkthen përkthyesja), kërkon fjalën dhe në thelb parashtron se jam dakord me shumicën e propozimeve që u bënë për rihapjen për garës për vendin vakant, duke

qenë se nuk kemi numrin e mjaftueshëm të kandidaturave edhe sipas parashikimeve të Kushtetutës. Kur vjen puna tek afati, në fakt jemi në kufijtë e një situatë shumë urgjente. Sepse vetë Kushtetuta e parashikon që të zgjidhet sa më shpejt çështja e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë. Aq më tepër duke patur në konsideratë faktin që do ishte e mira që ILD të ishte përzgjedhur edhe përpara vetë KED. Kjo gjendje ka krijuar shumë probleme në praktikë. Në momentin e realizimit të procedurave me vendet vakante do të ishte shumë e rëndësishme të ishin të miratuara aktet nënligjore. Por tashmë i kemi disa kritere për përzgjedhjen e ILD dhe patjetër bëhet urgjente, imediate, për tu vënë në zbatim ligji e që të hapet thirrja e vendit vakant për ILD. Patjetër që me pasjen e një skenari dhe realiteti ideal do të ishte e mira që të gjitha akte nënligjore të ishin miratuar dhe të ishin publikuar e kështu me radhë. Por duke qenë se periudha transitore tashmë është zvarritur dhe zgjatur shumë, duke pasur parasysh edhe nevojën, e duke qenë se jemi në rrugë të mbare tashmë me punën që po bëhet me aktet nënligjore, e mira është të hapet shpallja për pozicionin vakant.

Në përfundim të diskutimeve mes tyre, ***anëtarët e Këshillit unanimisht vendosën*** për të rishpallur hapjen e procedurës së aplikimit në pozicionin vakant për Inspektor i Lartë i Drejtësisë, me afat për paraqitjen e interesit nga kandidatët deri në datën 21 Mars, ndërsa kandidatët e deritanishëm mund të shprehen vetëm me rikonfirmim të vullnetit të tyre për vijimin e konkurrimit.

***Këshilli vijon mbledhjen*** me diskutimet për çështjen tjetër të rendit të ditës: *Diskutimi dhe miratimi i Projektvendimit për procedurat e verifikimit të kandidatëve për vendet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe për Inspektor i Lartë i Drejtësisë.*

***Ardian Dvorani*** paraqet qëllimin e projektaktit, strukturën dhe përmbajtjen në tërësi të dispozitave të këtij projektakti.

***Anëtarët e Këshillit dhe pjesëmarrësit e tjerë*** diskutojnë përmbajtjen e titullit, pjesës hyrëse dhe të dispozitave të Kreut I të projektaktit “Dispozita të përgjithshme”.

***Anëtarët e Këshillit miratojnë*** me disa shtesa dhe ndryshime dispozitat e këtij Kreu.

***Anëtarët e Këshillit dhe pjesëmarrësit e tjerë*** diskutojnë përmbajtjen e Kreut II “Rregulla të përgjithshme të procedurës së verifikimit”, duke filluar me Seksionin A “Fillimi dhe fazat e procedurës së verifikimit”, e vijuar me Seksionin B “Të drejtat e kandidatit” dhe Seksionin C “Afatet dhe llogaritja e tyre”.

***Këshilli*** ndërpret diskutimet për një pushim të shkurtër.

## **PJESA E DYTË E MBLEDHJES**

*Anëtarët e Këshillit dhe pjesëmarrësit e tjerë*, pas pushimit, vijnë diskutimet mbi përmbajtjen e Kreut II “Rregulla të përgjithshme të procedurës së verifikimit”, me Seksionin Ç “Njoftimet”.

*Anëtarët e Këshillit*, në përfundim të diskutimeve, *miratojnë* me shtesa dhe ndryshime dispozitat e Kreut II “Rregulla të përgjithshme të procedurës së verifikimit”.

*Anëtarët e Këshillit*, vijonë më diskutimin e dispozitave të Kreut III “Fazat e procedurës administrative të verifikimit të kandidatëve”, fillimisht me Seksionin A “Veprimet procedurale dhe verifikuese të relatorit”.

**Agnes Bernhard (përkthen përkthyesja)**, kërkon fjalën dhe parashtrohet se në këtë pikë ndoshta nuk është e nevojshme të jemi shumë formal sepse mund të ndodhë, për arsye njerëzore që një person mund të jetë i sëmure dhe nuk mund të paraqitet, atëherë sa më të shkurtra dhe më të thjeshta të jenë procedurat aq më mirë do të jetë për përsheptimin e procesit.

**Bledar Dervishaj**, kërkon fjalën dhe parashtrohet se ligji parashikon që Këshilli i pajis kandidatët me formularë dhe këto ditë kemi vënë se ligji ka ndryshuar. Për shembull janë ndryshuar formularët. Ka ndodhur tek vakancat tona që kandidatët kanë aplikuar me formularë të tjerë dhe pastaj ato kanë ndryshuar në qershor 2018. Ne vlerësuam atëherë që t’ja kërkonim të gjithë formularët që këshilli apo ne ti kishim gati. Prandaj, formularët duhen azhonuar.

Në lidhje me pikën 24-26 kemi një sugjerim. Ky veprim që kryen relatori, atributi që merr për njoftimin e relacionit paraprak, a mos duhet të ishte më mirë që edhe anëtarët e këshillit të shprehen dhe të vendosin njoftimin e relacionit paraprak. Pra, të njihen njëherë anëtarët e këshillit dhe pastaj relatori të bëjë njoftimin. Shtrohet pyetja a duhet ti njoftohet kandidatit edhe pse është relacion paraprak, pa u konsultuar njëherë me këshillin. Ky termi relacion paraprak mos i jep të kuptoj kandidatit një pritshmëri pozitive pa një vendim Këshilli apo edhe negative pa një vendim të tillë? Mund të kishte një riformulim teknik. Pra relatori përgatit relacionin paraprak përkatës dhe njofton kandidatin mbi gjetjet kryesore të tij. Mund të jetë si një njoftim për plotësim të dhënash, por jo si njoftim i relacionit. Duket sikur filloi arsyetimi mbi kandidatin kur i njofton një relacion.

**Erinda Ballanca**, kërkon fjalën dhe parashtrohet se shqetësimi që kam në këtë pikë, në lidhje me përgatitjen e këtij relacioni paraprak, është krijimi i mundësisë së dukjes në publik të standardeve të dyfishta. Si do të garantoj ky Këshill që i njëjti standard do të aplikohet nga secili prej relatorëve në thellësinë e investigimit dhe/ose verifikimit? Ky është një nga problemet kryesore që është edhe sot për vetëgjykimin, pra perceptimi i publikut dhe i

kandidatëve se standardet e aplikuara janë të ndryshme. Prandaj do të duhet të ketë një veprim të Këshilit dhe jo vetëm veprim të relatorit lidhur me relacion. Duhet që qëndrimi të jetë i standardizuar, i njëjtë për të gjithë kandidatët nga të gjithë relatorët. Në qoftë se dërgohet një relacion paraprak pa kaluar në Këshill, është një gjë që do të na krijojë probleme nesër nëse vendimmarrja e Këshilit do jetë e kundërt, sepse mund të dërgohet çështja nga kandidati në gjyq me pretendimin se kandidati ka pasur një relacion paraprak pozitiv dhe pastaj nga Këshill është dhënë vendim negativ sepse kishte vendimmarrje të caktuar, psh politike. Në Këshill për çështjet mund të kemi mendime të ndryshme për aspekte të ndryshme duke cituar të njëjtën dispozitë dhe nuk përjashtohet të na krijojë problem në perceptimin e gjithë punës së KED-së, duke bërë relacione paraprake individuale pa u këshilluar midis anëtarëve për një qëndrim të përbashkët. Problemi tjetër është nëse në procedurën e verifikimit njoftimi nga relatori do të bëhet kur marrim verifikimi për secilin kandidat apo kur të ketë mbaruar për të gjithë kandidatët.

**Agnes Bernhard (përkthen përkthyesja)**, kërkon fjalën dhe parashtrohet se pak a shumë ndaj të njëjtin mendim me atë që sapo përmendi dhe kolegu pak më përpara. Problemi mbetet tek emërtimi i këtij relacioni paraprak. Nga njëra anë nuk do të ishte e drejtë që të mos mbahej i informuar kandidati për ecurinë e situatës e që ai të pasurojë dokumentacion, ta përditësojë atë. Por, dhe nga ana tjetër, nuk do të ishte e drejtë që Këshilli të angazhohej me çdo lloj komunikimi. Kështu që mbetemi në fund tek terminologjia. Dhe në të njëjtën kohë ky komunikim duhet të mbetet i detajuar ku të adresohen të gjitha ato pikëpyetjet që janë gjatë rrugës gjatë procesit por gjithashtu të mos ketë natyrën e një raporti apo relacioni por të kthehem tek koncepti i vetë termit që të marrë formën e një raporti ose relacioni. Dhe gjithashtu të kemi pak në vëmendje formulimin e pikës “a” edhe “b” të pikës 26. Ndoshta edhe nga përkthimi por edhe në original ka momente që ka terma të përsëritur ose mbivendosje në metodologji.

**Kryetari i Këshillit Ardian Dvorani**, pasi merr mendimin e anëtarëve për ndërprerjen e diskutimeve dhe vijimin e tyre në mbledhjen e ardhshme, përcakton zhvillimin e saj në datën 8 Mars, në orën 10.00, me të njëjtin rend dite: *Diskutimi dhe miratimi i projektvendimit për procedurat e verifikimit të kandidatëve për vendet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe për Inspektor i Lartë i Drejtësisë*, deklaron mbylljen e mbledhjes.

## **MBLEDHJA MBYLLET NË ORËN 15.54**

**Sekretare**

**Kryetari**

**Dorina Dulaj**

**Ardian Dvorani**

**Ermelinda Kadiu**

**Redjona Myrtja**

Shënim: Diskutimet e zhvilluara në gjuhën angleze, janë reflektuar të përkthyer në këtë procesverbal.

Përkthimi është kryer nga personel i vetë institucioneve të ftuar.